



**KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR**  
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ  
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Numër 255-01/24

Data 26.03.2024

Bujanoc

Në bazë Nenit 113 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 14, paragrafi 1, pika 3 dhe 20 e Statutit të Këshillit të Kombëtar Shqiptar nr.284-01/23 të datës 06.07.2023, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar nr. 255-01/24, datë 26.03.2024, shpallim:

**THIRRJE PËR NDIHMË TË NJËHERSHME FINANCIARE PËR NXËNËSIT PA ASNJË PRIND OSE VETËM ME NJË PRIND (PRINDI/ËRIT I/E TË CILËVE KANË VDEKUR) DHE FAMILJET ME 3 OSE MË SHUMË FËMIJË NË PROCESIN EDUKATIVO-ARSIMOR**

Ftohen të gjithë nxënësit/familjet shqiptarë që ndjekin mësimin në shkollat me mësim në gjuhën shqipe (enti parashkollorë, shkollat fillore dhe të mesme), të aplikojnë për ndihmë të njëjshme financiare që Këshilli Kombëtar Shqiptar ndan në zbatim të Vendimit të qeverisë Nr. 08/L-260 nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, nën-programi “Përkrahje për Luginën e Preshevës” me kod 39100, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”.

Për ndihmën e njëjshme financiare do të përfshihen të gjithë nxënësit shqiptarë pa asnjë prind ose vetëm me një prind që ndjekin mësimin në shkollat me mësim në gjuhën shqipe (enti parashkollorë, shkollat fillore dhe të mesme) dhe familjet me 3 ose më shumë fëmijë në procesin edukativo-arsimor. Shuma e përkrahjes do të jetë e hapur për tu vlerësuar nga Komisioni Vlerësues pas marrjes së vendimit nga KKSH.

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Nxënësit shqiptarë pa asnjë prind ose vetëm me një prind, që ndjekin mësimin në shkollat me mësim në gjuhën shqipe në Luginë të Preshevës (enti parashkollorë, shkollat fillore dhe të mesme)
2. Familjet me 3 ose më shumë fëmijë në procesin edukativo-arsimor.
3. Aplikuesit mund të aplikojnë vetëm për njërën nga këto dy kategori.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen fizikisht në ambientet e selisë së Këshillit Kombëtar Shqiptar, në Rr. Karagjorgje Petroviq, nr. 237 gjatë orarit 09:00-15:00. **Afati i aplikimit është 01 Prill 2024-22 Prill 2024. Afati i fundit për aplikim është ora 15:00, datë 22.04.2024.**

Format për aplikim si dhe të gjitha informatat tjera gjinden në [kksh.org](http://kksh.org) (website i KKSH-së). Për informata shtesë ju lutem na shkruani në [kksh.grantet@gmail.com](mailto:kksh.grantet@gmail.com) ose na telefononi në nr. **0631408945**.

**Vërejtje:** Vetëm aplikimet e dorëzuara brenda afatit dhe me dosje të plotë do të shqyrtohen. Komisioni vlerësues pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve përpilon listën preliminare, e cila mund të ankimohej në shkallën e dytë nga aplikuesi, brenda një afati 8 ditor nga data e shpalljes së listës.

